



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 526/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkitazi me ankesën e Faton Beka, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës-PDAK, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të shpalljes së rezultateve preliminare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021 në seancën e panelit të mbajtur me 18.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr.526/2021 e datës 16.02.2021, të parashtruar nga Faton Beka, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës-PDAK, për shkak të shpalljes së rezultateve preliminare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021.

A r s y e t i m

Paneli, me datë 16.02.2021, ka pranuar ankesën A.nr.526/2021 nga Faton Beka, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës-PDAK, në të cilën pretendohet se pas publikimit të Formularëve të Përputhjes së Rezultateve-FPR, ka vërejtur se në vendvotimin me numër 1501e-01R nuk iu është shënuar vota e tij në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve-FRK.

Lidhur me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon të ndërmerren masa nga ana e PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në rezultatin e publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve-KQZ, për shkak se përmes kësaj ankesë atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e

procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës si të palejueshme nuk e prejudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë - apelojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 526/2021 më datën 18.02.2021

Kryesuesë e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.